




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE

24/06/2024

Nr. i Protokollit: 02/ 683

Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Gllavicë

E enjte, më 18 qershor 2024

Kohëzgjatja e takimit: 19:45 – 21:00

Vendi i takimit: SHF "Lasgush Poradeci"

Pjesëmarrës në takim ishin: Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi, Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi - Grejtalb Emiri dhe Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike – Bardhyl Rushiti, Asambleistët- Besnik Seferi, Gëzim Haxhiu dhe Sanie Sadiku.

Rendi i ditës:

1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027

Kryesuesi i Kuvendit, Adnan Ademi : Përshëndetje për të gjithë dhe faleminderit që sot ju keni përgjigjë ftesës që të jeni në këtë takim. Takimi ka të bëjë me Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin 2025-2027, ne sot realisht kemi pasur 4 fshatra dhe kemi filluar në Davidovc, Rashincë, Muzeqinë tani jemi në Gllavicë, pra çdo ditë jemi në katër fshatra. Fat i mirë është që në fshatin Gllavicë e kemi lënë pak më vonë dhe kemi një numër më të madh të banorëve pasi që në disa fshatra është më herët dhe për shkak të orarit banorët nuk po mund të marrin pjesë.

Po ndërlihem direkt për çështjen se pse ne jemi këtu, buxheti i Komunës së Shtimes do të thotë vitin e kaluar ka qenë afër 10 milion ndërsa tani për vitin 2025 është fat i mirë që kemi një rritje ku buxheti do të jetë afër 11 milion dhe kësaj parashihet që çdo vit ky buxhet të ketë rritje. Buxheti në Komunën e Shtimes mirëpo edhe në të gjitha komunat ndahet në bazë të numrit të banorëve dhe ne mundohemi që buxhetin ta ndajmë për secilin fshat në komunën tonë.

Mbi 50% e buxhetit në të gjitha komunat shkon për pjesën e pagave dhe mëditjeve, në vitin e kaluar pagat janë rritur nga qeveria Kurti dhe kësaj i bie që ne kemi një rritje të buxhetit afro 1 milion euro në Shtime, pjesët e tjera mbesin investimet kapitale, mallra dhe shërbime si dhe shpenzimet komunale. Për vitin 2025 kemi planifikuar që subvencionet t'i rrisim nga 350 mijë në 500 mijë euro dhe kësaj do të kenë edhe rinia, bujqësia e shëndetësia mjete më shumë se viti paraprak.

Buxheti i Komunës së Shtimes vitin e kaluar është shpenzuar 95% në përqindje, këtë rast kemi arrit që të menaxhojmë buxhetin mirë, po ashtu kemi përfituar edhe një grant të performancës nga MAPL i cili e ka vlerën prej 400 mij euro, jemi ranguar si qeverisje ndër pesë Komunat më të mira,

me këtë grant të cilin e kemi përfituar kemi planifiku që ta bëjmë të tërin ndriçim publik në Komunën e Shtimes ku do të përfshihen të gjitha fshatrat dhe lagjet urbane. Sot ne jemi këtu që t'i marrim kërkesat e banorëve të fshatit Gllavicë, që ju t'i caktoni prioritetet e fshatit tuaj.

Kërkesat e banorëve të fshatit :


- Shaban Krasniqi : Lagjia e "Gurëve", ka nevojë për ndriçim dhe gjithashtu të bëhet emërtimi i lagjes pasi që nuk ka emër. Po ashtu në fshatin ton është i nevojshëm një park. Rruga Gllavicë-Koshare është prishur dhe ka nevojë për rivitalizim.
- Nuhi Hoxha: A do të ketë projekt për vazhdimin e trotuarit deri në Koshare dhe ndriçimin gjithashtu?
- Fadil Hoxha: Fusha e sportit e cila është ndërtuar në fshatin tonë e ka bllokuar rrugën e arave tek pjesa bujqësore. Kanalizimi të rregullohet tek disa shtëpi pasi që nuk kemi, aneks i rrugës "Galica", përball fushës, 120 metra, gjithashtu edhe asfaltim.
- Halil Krasniqi: Fusha e cila është ndërtuar nuk ka ndriçim. Nuk kemi transport për udhëtar dhe është një problem i madh.
- Gëzim Krasniqi: Nuk janë hequr betonët tek fusha e cila është ndërtuar dhe tani rruga për në ara është bllokuar.
- Arton Hashti: Segmet i rrugës kryesore, përball shkollës të asfaltohet.
- Anila Hoxha: Të vendosen tabela për mos hudhjen e mbeturinave. Dhe kam një pyetje sa i përket një parku në fshatin ton kur pritet të bëhet dhe ku?
- Nuhi Hoxha: Është mirë që të bëhet një list e rrugëve të cilat duhet asfaltohet dhe të vendosen prioritetet.
- Valmira Hoxha: Qent endacak janë një problem i madh për fëmijët dhe banorët.
- Milazim Guri: Oborri dhe tortuari i shkollës të rregullohen.

Procesmbajtës
Gentiana Mehmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO






KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik në Gllavicë

Date: 18/06/2024

Nr	Emri dhe Mbiemri	Nenshkrimi
1	Shaban KRASNIQI	
2	FATMIR Hoxha	
3	Mirza GURU	
4	Faahil Hoxha	
5	MICAFI GURU	
6	Jurim Bungu	
7	Gëzim Krasniqi	
8	Azmine Krasniqi	
9	Ridvan Hoxha	
10	Holil Krasniqi	
11	Denis Hoxha	
12	Anila Hoxha	
13	Leutrim Hoxha	
14	FYRIJET Hoxha	
15	Nurri Hoxha	
16	Jozoziç BUNGU	
17	Valmina Hoxha	

18	Arzon Gashi	
19	ISA BUNGU	
20	MIFTAR KRSMIGI	
21		
22		
23		
24		
25		
26		
27		
28		
29		
30		
31		
32		
33		
34		
35		
36		
37		
38		
39		
40		
41		